

VENDIM
Nr.26, datë 11.1.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 248, DATË 27.4.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË
SHOQËRISË SË INFORMACIONIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 19 të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.248, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Pas shkronjës “m” të pikës 3 shtohen shkronjat “n” dhe “nj”, me këtë përmbajtje:
“n) zhvillon dhe ofron shërbimet e përqendruara elektronike për administratën publike;
nj) krijon dhe administron infrastrukturën qeveritare të Çelësit Publik (PKI).”.
- b) Shprehja “...Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin...” zëvendësohet me “...Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit...”;
- c) Shprehja “...në fushën e komunikimeve elektronike...” zëvendësohet me “... në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare...”.

2. Me garancinë financiare si institucion qeveritar, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit siguron pajtueshmërinë me nenin 19 të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik.”.

3. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha